



Nr. 22/2025  
Dt. 30.04.2025



KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS Sh.A.  
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.  
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

## Bordi i Drejtorëve i Korporatës Energjetike të Kosovës Sh.A.

Duke i ushtruar detyrat dhe përgjegjësitë ligjore konform Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr.03/L-087, Ligjit Nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, si dhe Ligjit Nr. 05/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087, si dhe në mbështetje të dispozitave nga Rregulloret e ndërmarrjes, neni 4 i kreut III që rregullon të drejtat dhe përgjegjësitë e tij, Bordi i Drejtorëve i emëruar me **Vendim të QRK nr. 02/253, dt. 21.03.2025**, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 30.04.2025, duke vepruar me kuorum dhe me votim një zëri, mori këtë:

### I. Për miratimin e Raportit Vjetor të Korporatës Energjetike të Kosovës për vitin 2024.

#### Arsyetimi

Në pajtim me obligimin ligjor sipas legjislacionit në fuqi, Bordi i Drejtorëve ka nxjerrë Vendim me dt.14.03.2025, (nr. prot.1891) për miratimin e Raportit Vjetor të KEK-Sh.A për vitin 2024 në pajtim me nenin 31.1, 31.2 dhe 31.3 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike (me plotësimet dhe ndryshimet e ndodhura), version i përshtatur sipas kërkesave ligjore të Ligjit Nr. 06/l-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim. Bordi i Drejtorëve ka miratuar Raportin Vjetor të KEK-Sh.A pas aprovimit të Pasqyrave Financiare për vitin 2024 të audituara nga Auditori i Jashtëm. Menaxhmenti është zotuar duke e siguruar Bordin e Drejtorëve, se i ka marrë të gjitha veprimet që ndryshimet e ndodhura si rezultat i miratimit të Pasqyrave Financiare të audituara nga Auditori i Jashtë të reflektohen në Raportin Vjetor të KEK-Sh.A.

Bordi i Drejtorëve autorizon Sekretarin e Korporatës që versionin e miratuar të Raportit ta dërgojë te Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike (NJPMNP), në Ministrinë e Ekonomisë, obligohet Zyrtarit Kryesor Financiar i KEK-Sh.A që ta dorëzojë të njëjtit te Këshilli Kosovarë për Raportim Financiar (KKRF), pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

Vendimi hyn në fuqi me ditën e nënshkrimit të tij.

**Shtojcë:** Raporti Vjetor i Korporatës Energjetike të Kosovës për vitin 2024 (versioni i përditësuar me Pasqyrat Financiare të audituara nga Auditori i Jashtë).

#### I dërgohet:

1. Divizionit të Financave
2. Sekretaria e Ndërmarrjes
3. Arkivi KEK
4. NJPMNP-ME
5. KKRF-MFPT

Në emër të Bordit të KEK-Sh.A  
Kryesues i Bordit të Drejtorëve

Valdrin Krasniqi

Datë  
30.04.2025





KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS Sh.a.  
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.  
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.O.



---

## Raporti Vjetor

01 Janar 2024 – 31 Dhjetor 2024

---



## PËRMBAJTJA E RAPORTIT

<b>NË VEND TË HYRJES.....</b>	<b>3</b>
<b>RAPORTI I BORDIT TË DREJTORËVE.....</b>	<b>4</b>
Aktivitetet dhe Performanca e Ndërmarrjes.....	4
Informacion lidhur me Kapitalin dhe Dividendën.....	5
Të dhënat për Drejtorët Jo-Ekzekutiv.....	5
<b>RAPORTI I DREJTORIT MENAXHUES.....</b>	<b>7</b>
Ngjarjet Kryesore të vitit 2024.....	7
Performanca Operative dhe Indikatorët kyç të Performancës.....	10
Indikatorët kyç të Performancës për vitin 2024.....	10
Divizioni i Mihjeve.....	11
Divizioni i Gjenerimit.....	12
<b>PRODHIMI NË TCB.....</b>	<b>13</b>
<b>PRODHIMI NË TCA.....</b>	<b>13</b>
Performanca Financiare dhe Rezultatet.....	15
Gjendja e Kompanisë dhe krahasimet me vitin 2023.....	15
Pasqyra e të hyrave dhe krahasimet me vitin 2023.....	16
Pasqyra e shpenzimeve dhe krahasimet me vitin 2023.....	17
Realizimi i Buxhetit në vitin 2024.....	17
Shpenzimet kapitale dhe projektet.....	22
Divizioni i Mihjeve.....	22
Divizioni i Gjenerimit të Energjisë.....	23
Divizioni i Shërbimeve të Korporatës.....	24
Progresi i Projekteve Kapitale.....	24
Reziqet e Korporatës.....	25
RAPORTIMET SHITESË PËR AKSIONARIN.....	28
Struktura Organizative KEK Sh.A 2024.....	32
Transaksionet e Konsiderueshme.....	33
<b>SYGJERIME DHE PROPOZIME.....</b>	<b>34</b>

## Në vend të hyrjes

Edhe gjatë vitit 2024 stabiliteti i prodhimit të energjisë dhe rritja e kapaciteteve për KEK mbetet njëra nga sfidat kryesore. Efektet post krizave të fundit vërehen në sektorin e energjisë duke shkaktuar zhvendosjen në kohë të projekteve të donacionit të BE-së, rrjedhimisht duke ndikuar edhe në procesin e investimeve të lidhura me rivitalizimin e TCB dhe shtyrjen e modernizimit të turbinave. Megjithatë një zhvillim i rëndësishëm për KEK gjatë vitit 2024 ishte aprovimi i strategjisë zhvillimore 2024-2028 nga Bordi i Drejtoreve duke hapur rrugën investimeve të reja në sektorin e energjisë. Shto kësaj edhe efektet e krizave (mungesa e energjisë në treg dhe çmimet e larta), të cilat përshpejtuan nevojën e vendit për rritjen e kapaciteteve të brendshme të energjisë, në mënyrë që të zvogëlohet varësia energjetike. Në këtë drejtim KEK gjatë vitit 2024 ka realizuar aktivitete, në drejtim të investimeve në energji të ripërtrishme me bazë solare si dhe aprovimin e projektit për tenderim për rindërtimin e njësisë A3.

Përkundër remonteve të planifikuara dhe investimeve kapitale në njësitë gjeneruese të prodhimit të energjisë elektrike në vitin 2024, energjia e prodhuar ose në dispozicion për treg ishte për 11.40% më e lartë krahasuar me vitin paraprak. Energjia e prodhuar gjatë vitit 2024 ishte 5.49 milion MWh e cila krahasuar me vitin paraprak është për 0.56 milion MWh më e lartë (2023: 4.93 milion MWh). Gjatë vitit 2024 KEK kishte një rritje të ndjeshme të prodhimit të thëngjillit me 16.54% krahasuar me vitin paraprak. Prodhimi i thëngjillit në 2024 u realizua në 8.06 milion ton (2023: 6.9 milion ton).

Edhe gjatë vitit 2024 KEK ka vazhduar me performancë pozitive financiare, duke realizuar një fitim neto prej €39.1 milion. Dallimi i madh në rezultatin financiar krahasuar me vitin paraprak, vjen nga rritja e te hyrave nga shitja e energjise elektrike ne vlere 19 milion dhe realizimi i te hyrave tjera nga rimbursimi i mjeteve financaire nga Administrata Tatimore e Kosoves ne vlere 13.9 mil. Rezultati financiar, pasqyron edhe efektet e stabilizimit të çmimeve e cila dha efekt në të hyrat nga veprmtaria e korporatës, të cilat në 2024 ishin €194.3 milion (2023: €180.8 milion).

Rezultati i mirë financiar, bën që korporata të gëzojë likuiditet të lartë dhe të mos rrezikoj me problemet e shlyerjes së detyrimeve të veta afatshkurtër. Megjithatë dy nga sfidat kryesore me të cilat duhet të fokusohet KEK, lidhen me nivelin e realizimit të investimeve kapitale, e cila paraqet një rrezik të cilin duhet menaxhuar me kujdes në periudhat në vijim, në mënyrë që të realizoj qëllimin e vet për stabilitet në prodhimin e energjisë dhe rritja e llogarive të arketueshme nga pa mundesia e inkasimit të shitjeve të realizuara për furnizuesin me shumicë KESCO.

**Z. Gezim Paci**

UD Zyrtar kryesor i financave  
dhe thesarit

**Z. Gramos Hashani**

UD Zyrtar Kryesor Administrativ

**Z. Valdrin Krasniqi**

Kryesues i Bordit





## **RAPORTI I BORDIT TË DREJTORËVE**

### ***Aktivitetet dhe Performanca e Ndërmarrjes***

Bordi i Drejtorëve të KEK-ut, funksionon dhe operon me kompetencë në realizimin e aktiviteteve të rregullta për vitin 2024. Nga perspektiva e Bordit të Drejtorëve, aktivitetet kryesore të ndërmarrja gjatë vitit ndërlidhen kryesisht me përcjelljen dhe mbikëqyrjen e realizimit të planeve operative dhe kapitale në ndërmarrje. Për të realizuar këtë, Bordi ka shqyrtuar rregullisht performancën financiare dhe operative, kryesisht gjatë takimeve të rregullta të Bordit, ndërsa, në këtë drejtim është përkrahur edhe nga Komisioni i Auditimit. Po ashtu ka përmbushur detyrimet për vendimmarrje dhe në vendosjen e rregullave të korporatës, këto përgjegjësi përfshijnë krijimin dhe zbatimin e rregullave të brendshme për të siguruar funksionimin e qetë të ndërmarrjes, sigurimin e burimeve të mjaftueshme për të ofruar shërbimet në mënyrë etike ekonomike dhe efikase, si dhe mbrojtjen e integritetit të të dhënave ndërsa respekton ligjet për të përmirësuar vlerën e aksionarit.

Performanca operative dhe financiare gjatë vitit 2024 ka shënuar ngritje në krahasim me vitin paraprak. Kompania gjatë këtij viti ka rezultuar me fitim.

Rezultatet e mira janë vërtetuar dhe nga raporti i auditorëve të pavarur për vitin e kaluar dhe njëjtë shpresohet të arrihet edhe në auditimin e pasqyrave financiare për vitin 2024, opinion të pakualifikuar. Edhe raportet tremujore dhe vjetore janë miratuar gjatë vitit, sipas kërkesës së Ligjit për ndërmarrjet publike.

Rezultatet e mira financiare bëjnë që korporata të gëzojë likuiditet të lartë dhe të mos rrezikojë me problemet e shlyerjes së detyrimeve të veta afatshkurtra. Megjithatë një nga sfidat kryesore në të cilën duhet të fokusohet KEK-u lidhet me nivelin e realizimit të investimeve kapitale e cila paraqet një rrezik, të cilin duhet menaxhuar me kujdes në periudhat në vijim në mënyrë që të realizojë qëllimin e vet, në rritjen e sigurisë të pajisjeve për prodhimin e energjisë elektrike. Po ashtu për KEK-un, sfida është edhe zëvendësimi i kuadrove të fushës teknike me kohë para se të pensionohen ky kuadër.

Aktivitetet më të rëndësishme gjatë vitit janë realizuar në drejtim të investimeve të burimeve të ripërtrishme, siç është projekti i Parkut Solar 100 MW si dhe përgatitjet për rehabilitimin e Bllokut A-3 të TCA e gjithë këto në rritje të kapaciteteve të brendshme të energjisë elektrike me qëllimin e zvogëlimit të varësisë energjetike si dhe në rritjen e sigurisë së mbulimit të konsumit të energjisë elektrike me burime vendore.



## **Informacion lidhur me Kapitalin dhe Dividendën**

Në vitin 2024 ndërmarrja nuk ka nënshkruar asnjë kredi të re ndërsa gjatë vitit ka kryer obligimet për kreditë e marra nga Ministria e Financave duke kryer pagesat në bazë të normave të interesit të BQE dhe BQK . KEK ka marrëveshje me Ministrinë e Financave dhe ri-programimit të saj në vitin 2015, të cilës i përmbahet. Gjatë vitit 2024 është shlyer pjesa afatshkurtër e huamarrjes në vlerë prej €11.4 milion dhe interesi i kalkuluar prej € 0.55 milion.

(në €' 000)	2024	2023
<b>Pjesa afatgjatë</b>		
Kredia e MF që bart interes	94,841	103,992
	<b>94,841</b>	<b>103,992</b>
<b>Pjesa afatshkurtër</b>		
Kredia Interes bartëse nga MF –Pjesa afatshkurtër	9,151	11,387
Interesi Akruar (jo i vonuar)	548	609
	<b>9,699</b>	<b>11,996</b>
<b>Total huazimet</b>	<b>104,540</b>	<b>115,988</b>

Gjatë kësaj periudhe ndërmarrja ka realizuar investimet kapitale nga fondet vetanake, që gjithsej arrijnë vlerën prej rreth €42.16 milionë. Ndër këto investime, të rëndësishme janë edhe në aspektin e përmirësimit dhe ndikimit mjedisor nga Termocentrali Kosova A, investimet në Mihje si dhe investimet në Kosovën B.

Përkundër konsolidimit të pozitës financiare në 5 vitet e fundit, Korporata nuk do të ndajë dividendë për aksionarin, pasi që në vitin 2025 dhe vitet vijuese priten investime kapitale të mëdha në rehabilitimin e njësive të gjenerimit (në TCA -njësia A3 dhe TC B) dhe investime në BRE, prandaj KEK duhet të këtë likuiditetin e duhur për realizimin e këtyre projekteve madhore.

### **Të dhënat për Drejtorët Jo-Ekzekutiv**

Në pajtim me nenin 15 të ligjit 038/L-87 për ndërmarrjet publike aksionari ,Qeveria e Kosovës emëron dhe shkarkon anëtarët e bordeve të ndërmarrjeve publike qendrore. Mbi këtë bazë konform nenit 15 ose 16 të ligjit për NP sipas Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02/253, dt.21.03.2025, për Drejtorë të Bordit NPQ Korporata Energjetike e Kosovës ( KEK-SH.A) janë emëruar:

1. Valdrin Krasniqi, kryesues
2. Merita Kasapolli, anëtare
3. Filloretë Gashi-Sadiku, anëtare
4. Shpetim Zharku, anëtar.

Sipas Vendimit të Ministrisë së Ekonomisë Nr. 1521, dt.24.03.2025 , është emëruar Komisioni i Auditimit me këtë përbërje:

1. Shpetim Zharku, kryesues
2. Filloretë Gashi-Sadiku, anëtare
3. Merita Kasapolli, anëtare



Me vendimin nr.02/52 të datës 02.02.2022 pas përfundimit të procedurave të rregullta ka përzgjedhur Bordin e përhershëm të KEK sh.a me mandat tre vjeçar.

Me vendimin nr. 01/166 të datës 15.10.2023, Aksionari ka emëruar Bordin me këtë përbërje:

1. z. Artan Ahmeti- drejtor jo-ekzekutiv - Kryesues
2. z. Skender Haziri - drejtor jo-ekzekutiv - anëtar
3. znj. Valbona Raifi-Deshishku - drejtoreshë jo-ekzekutive- anëtare
4. z. Mustafë Pllana - drejtor jo-ekzekutiv - anëtar
5. z. Valdrin Krasniqi - drejtor jo-ekzekutiv - anëtar
6. znj. Merita Kasapolli - drejtoreshë jo-ekzekutive - anëtare

Qeveria e Republikës së Kosovës ka nxjerrë Vendim nr. 20/214, dt. 24.07.2024 duke ndryshuar dhe plotësuar par.1 të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 02/58 i datës 02.02.2022 i ndryshuar dhe plotësuar me vendim nr. 01/116 dt. 15.10.2023 me përbërje:

1. z. Valdrin Krasniqi - drejtor jo ekzekutiv - Kryesues
2. znj. Merita Kasapolli - drejtoreshë jo-ekzekutive - anëtare
3. znj. Valbona Raifi-Deshishku - drejtoreshë jo-ekzekutive - anëtare
4. z. Mustafë Pllana- drejtor jo-ekzekutiv - anëtar

Ndërsa, Komisioni i Auditimi është emëruar me vendim nr. port 941, dt. 26.04.2022 të Ministres të Ministrisë së Ekonomisë, bazuar ne nenin 14 te ligjit Nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, në këtë përbërje:

1. znj. Valbona Raifi-Deshishku - kryesuese
2. z. Valdrin Krasniqi - anëtar;
3. znj. Merita Kasapolli - anëtare.

Ndërkohë, Komisioni i Auditimit është ndryshuar në përbërje me Vendim të Ministrisë së Ekonomisë nr. prot. 5185, dt. 26.07.2024

1. z. Mustafë Pllana zëvendëson z. Valdrin Krasniqi

Gjatë kësaj periudhe Bordi ka mbajtur 17 takime (14 të rregullta dhe 3 të jashtëzakonshme).

Në kuadër të Bordit të Drejtorëve ka vepruar komisioni i Auditimit:

1. Komisioni i Auditimit, i cili ka realizuar 11 takime gjatë vitit 2024.

## **RAPORTI I DREJTORIT MENAXHUES**

### ***Ngjarjet Kryesore të vitit 2024***

Pavarësisht sfidave lokale dhe rajonale, Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A. (KEK) ka vazhduar procesin e konsolidimit dhe pavarësimit financiar, duke u përputhur me obligimet e saj ligjore dhe publike si ofruesi i vetëm publik i shërbimeve të energjisë elektrike. KEK-u ka një mision të qartë: të sigurojë shërbime të besueshme, të sigurta dhe me çmime të arsyeshme të energjisë elektrike, duke ruajtur njëkohësisht përgjegjësinë ndaj ambientit dhe qëndrueshmërinë financiare.

Pavarësisht sfidave të përmendura, viti 2024 ishte një vit i suksesshëm në realizimin e objektivave të parashikuara në planin e biznesit dhe në përmirësimin e parametrave kyç të korporatës.

KEK-u vazhdon të mbetet një kompani financiarisht e vetë qëndrueshme dhe likuide, duke investuar vazhdimisht në projekte kapitale me mjete vetanake. Këto investime përfshijnë përmirësimin e kapaciteteve prodhuese dhe gjeneruese të energjisë elektrike, si dhe projekte për mbrojtjen e ambientit, të cilat do të vazhdojnë edhe në vitet e ardhshme.

Investimet në projekte për zvogëlimin e ndotjes dhe rikultivimin e tokave janë një hap i rëndësishëm në përpjekjet për të mbrojtur ambientin dhe për të pasur ndikim pozitiv në komunitet. Gjithashtu, iniciativa për mbjelljen dhe mirëmbajtjen e fidanëve ka potencialin të ndihmojë në përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe në krijimin e hapësirave më të gjelbërta për qytetarët.

Në funksion të rritjes së kapaciteteve të veta gjeneruese, gjatë vitit 2024 kane vazhduar dhe janë zhvilluar aktivitete të rëndësishme në drejtim të realizimit të projektit të solarëve.

**Projekti për ndërtimin e parkut solar** paraqet një hap të rëndësishëm për energjinë e ripërtrishme në Kosovë, duke kontribuar në diversifikimin e burimeve të energjisë dhe në mbështetje të qëndrueshmërisë energjetike. Aktivitetet për zgjedhjen e kompanisë konsulente dhe përgatitjen e dosjes së tenderit për parkun solar kanë përfunduar me sukses, duke e çuar përpara procesin e realizimit të projektit. Me 01.08.2024, është nënshkruar marrëveshja bazë me EIB, si dhe marrëveshja e veçantë mes KEK dhe KfW për grantin dhe kredinë ndërmjet KEK-ut dhe Ministrisë së Financave. Pas nënshkrimit të marrëveshjeve të veçanta për nën grantin dhe nën kredinë, është përzgjedhur kompania konsulente për përgatitjen e dosjes së tenderit për ndërtimin e parkut solar. Në vazhdim, janë zhvilluar takime të rëndësishme me kompaninë fituese dhe me tender-agjentin e KfW-së për. Me 30 gusht 2024, janë dorëzuar kërkesat për përfshirjen e projektit solar në Hartën Zonale të Komunës së Obiliqit, duke bashkangjitur certifikatat e pronësisë dhe komunikimet e mëparshme me KEK.

Versionin final të kontratës, KEK-u e ka dërguar tek KfW për miratim me 05.09.2024, dhe pas shqyrtimit, më 16.09.2024, KfW ka dhënë miratimin pa vërejtje për kontratën e konsulentit implementues solar. Takimi i parë ndërmjet KEK, KfW dhe kompanisë konsulente është mbajtur më 24 tetor 2024, ku janë diskutuar çështjet e përcaktuara sipas dosjes së tenderit për përgatitjen e dosjes së tenderit për ndërtimin e parkut solar. Drafti i raportit fillestar për projektin e parkut solar 100 MW është dërguar më 30 dhjetor 2024. Pas analizimit të këtij



raporti, janë përgatitur dhe dorëzuar komentet nga Njësia për implementimin e projekteve nga KEK-u dhe KfW. Kostoja e vlerësuar e projektit është si vijon: Vlera e ulët: 47.9 milion Euro, Vlera e mesme: 59.5 milion Euro dhe Vlera e lartë: 70.2 milion Euro.

Bazuar në raportin fillestar, procesi për finalizimin e projektit të parkut solar do të zhvillohet sipas renditjes së mëposhtme:

- Përgatitja e fazës parakualifikuese – prill 2025
- Prosesi i parakualifikimit – prill-qershor 2025
- Prosesi i përzgjedhjes së kompanisë – korrik-nëntor 2025
- Përzgjedhja e kompanisë për implementimin e projektit dhe nënshkrimi i kontratës – tetor 2025
- Ndërtimi i parkut solar – nëntor 2025 - nëntor 2027

Ky projekt ka potencial të madh për përmirësimin e sektorit të energjisë në Kosovë, duke kontribuar në rritjen e kapaciteteve të energjisë rinovueshme dhe duke mbështetur qëndrueshmërinë energjetike të vendit.

Një nga sfidat kryesore të KEK-ut për vitin 2024 është shtyrja e **projektit të elektrofiltrave (ESP) dhe De-NOx-it për njësinë B1 në vitin 2026 dhe njësinë B2 në vitin 2027**. Ky projekt ambiental, i financuar nga Zyra e BE-së në Prishtinë me vlerë 76.4 milionë euro, bazohet në Studimin e Fizibilitetit të realizuar në Kosova B gjatë viteve 2016-2017. Arsyet e vonesave për implementim janë: Pandemia COVID-19 (nga 2020-2021 në 2021-2022), falimentimi i anëtarit të konzorciumit HAMON që krijoi vonesa të mëtejshme, problemet teknike në kaldajat B1 dhe B2 (projekti i dilatimeve), që e shtynë më tej implementimin në periudhën 2024-2025 dhe me kosto shtesë.

Në takimin e realizuar në korrik 2024 me përfaqësuesit e Zyrës së Bashkimit Evropian përfaqësuesit e KEK-ut u informuan, që konsorciumi i ri ka kërkuar një kosto shtesë prej 24.6 milionë euro dhe se Komisioni ka ndarë 10 milionë euro shtesë, përfshirë 3 milionë euro të dhënë deri në vitin 2024, duke rritur vlerën totale të projektit në 84 milionë euro. Po ashtu është planifikuar që një kompani të kontraktohet për të përgatitur një analizë financiare mbi arsyeshmërinë e kostove shtesë. Në shtator 2024 mbahet takimi fillestar virtual me kompaninë konsulente të përzgjedhur për analizën financiare.

Në takimin e mbajtur më 17 dhjetor 2024 në Zyrën e BE-së, KEK-u u njoftua nga kontraktori dhe BE-ja se projekti i elektrofiltrave (ESP) dhe De-NOx-it (kontrata nr. 2019/411 240) nuk mund të zbatohet në vitin 2025 siç ishte planifikuar (prill – nëntor 2025). Projekti do të nisë në vitin 2026 për njësinë B1 dhe në 2027 për njësinë B2. Për t'iu shmangur më shumë vonesave, menaxhmenti i KEK-ut ka marrë vendim që projektet të cilat janë në fazën e zbatimit dhe ato të planifikuara për vitin 2025, do të zhvillohen sipas planit pa shtyrje. Në këtë kuadër, projekti i modernizimit të turbinave dhe projektet e tjera do të zhvillohen në vitin 2025 në njësinë B2, ashtu siç ishte parashikuar. Kurse lidhur me renditjen e realizimit të projekteve të ESP dhe deNOx, KEK-u ka vendosur që njësia e parë që do të kalojë në realizim gjatë vitit 2026 do të jetë njësia B1, ndërsa në vitet në vijim do të zhvillohet njësia tjetër. Lidhur me vendimin e menaxhmentit të KEK-ut, BE u informua përmes letrës së datës 13 janar



2025. Amandamenti i 8-të është aktualisht në proces dhe do të përfshijë Anëtarin e ri të konzorciumit (FZ Solution), disa çështje teknike që lidhen me DeNOx të identifikuara në 2023 gjatë kohës së implementimit të kontratës së dilatimeve të kaldajave respektivisht gjatë kohës së kryerjes së testit të performances si dhe koston shtesë të projektit (25 Mil euro), e cila është diskutuar me përfaqësuesit e BE-së dhe Dornier Group.

Nga ana tjetër, pas aprovimit të PVZH-së nga MMPHI kanë vazhduar aktivitetet për shpronësimin e tokave për qëllime minerare, zhvendosjen fizike dhe ekonomike të një pjesë të fshatrave 72.4 ha dhe 28.3 ha si dhe nënshkrimi i kontratave noteriale. Gjatë vitit 2024 janë realizuar 268 pako të shpronësimit, kurse 18 pako pritet të shkojnë në procedurën e shpronësimit sipas Ligjit të shpronësimit (për shkak refuzimit nga palët, mos kompletim të dokumentacionit nga palët, si dhe mungese të zotësisë së veprimit). Në këtë kuadër, kemi siguruar nga Komuna e Obiliqit të gjitha dokumentet e nevojshme për përgatitjen e tij, siç janë çertifikatat pronësore me kopje plani dhe vektor. Gjithashtu, kërkesa për shpronësim është e gatshme dhe, pas përgatitjes së elaboratit për shpronësim, do të nënshkruhet nga Kryeshefi Ekzekutiv i KEK-ut, dhe do të dorëzohet në organin shpronësues - Qeverinë e Kosovës për nxjerrjen e vendimit përfundimtar për shpronësim. Departamenti i Pronës ka përgatitur të gjitha dosjet për kontratat noteriale për bartjen e patundshmërive në emër të KEK-ut, të cilat janë përpiluar gjatë vitit 2024, dhe të njëjtat janë dorëzuar për ekzekutim në Komunën e Obiliqit.

Bazuar në kërkesën e Ministrisë së Ekonomisë, është plotësuar "Plani Kombëtar për Zhvillim (PKZH) 2025-2027" me projektet e KEK-ut dhe është analizuar koncept-dokumenti për energjinë termike i përgatitur nga Ministria. Më 19 dhjetor 2024, KEK-u ka dorëzuar në Ministrinë e Ekonomisë listën e projekteve relevante për Planin Kombëtar për Integritet Evropian (PKIE) 2025-2028.

Po ashtu, Strategjia Zhvillimore e KEK-ut 2024-2028 është miratuar nga Bordi më 13 dhjetor 2024. Kjo strategji do të mundësojë hartimin e planeve zhvillimore dhe investive afatmesme për njësitë punuese DPQ, TCA dhe TCB.

Gjatë vitit 2024 janë marrë masa për funksionimin e duhur të kontrolleve të brendshme, duke lëshuar një sërë urdhëresash ekzekutive dhe vendime më qëllim të rregullimit të aktiviteteve të brendshme të Korporatës në përputhje me kërkesave ligjore dhe vendimet e institucioneve përkatëse. Njëra ndër objektivat strategjike të KEK-ut, për këtë vit ka qenë edhe përkujdesja për shëndetin e punëtorëve. Në kuadër të përgjegjësisë sociale, ndërmarrja ka realizuar projektin e sigurimit shëndetësor suplementar, duke mbuluar sigurimin shëndetësor për të gjithë punëtorët me mjete buxhetore të kompanisë. Për këtë qëllim është lidhur një kontratë me kohëzgjatje tre-vjeçare e cila do të mbetet në fuqi deri në hyrjen në fuqi të Ligjit për sigurimin shëndetësor dhe fillimin e mbledhjes së premiumeve në përputhje me aktet nënligjore që pritet të miratohen nga Ministria e Shëndetësisë.

KEK-u vazhdon të investojë në zhvillimin e kuadrove të brendshme, duke mundësuar një tranzicion gradual nga stafi i shtyrë në moshë drejt një gjenerate të re profesionistësh.



## Performanca Operative dhe Indikatorët kyç të Performancës

### Indikatorët kyç të Performancës për vitin 2024

Viti 2024 ka qenë një vit i mirë duke u bazuar në mbulimin e kërkesave për energji elektrike. Indikatorët Kyç të Performancës (IKP) nëpër divizione kanë shënuar progres. Realizimi përafërsisht i planit ka qenë pikë reference por në të shumtën e rasteve Divizionet kanë performuar mirë duke e përmbushur përafërsisht planin. Në këtë vit performanca ka rezultuar me një rritje të prodhimit të energjisë rreth 10 % në raport me vitin paraprak 2023.

Indikatorët Kyç të Performancës të cilët janë raportuar nga divizionet shërbyese brenda korporatës siç janë: financat, zyra ligjore, burimet njerëzore dhe shërbimet e korporatës, ofrojnë të dhëna në bazë të aktiviteteve për raportim në baza periodike. Informatat janë të rëndësishme për ecurinë e gjendjes financiare apo raportimin e gjendjes së të punësuarve që i shërbejnë Menaxhmentit dhe Bordit lidhur me marrjen e vendimeve të tanishme dhe vendimeve strategjike për të ardhmen e Korporatës.

### Performanca e Prodhimit

Bazuar në të dhënat e tabelës së mëposhtme duke krahasuar vitin paraprak 2023 në bazë të analizës së Performancës së Prodhimit gjatë këtij viti 2024, KEK-u sh.a. ka arritur të tejkalojë realizimin e prodhimit të energjisë elektrike dhe realizimin e prodhimit të qymyrit. Performanca ka rezultuar me një rritje të prodhimit të energjisë elektrike rreth 9.94 % dhe prodhimit të qymyrit rreth 17.08 % në raport me vitin parapak 2023.

Realizimi i Prodhimit KEK ShA	Energjia në MWh		Variacioni në %	Thëngjilli në ton		Variacioni në %
	janar-dhjetor 2024	janar -dhjetor 2023		janar-dhjetor 2024	janar-dhjetor 2023	
	5,494,964	4,998,201	9.94	8,106,057	6,923,659	17.08

Rezultatet e prodhimit të realizuar tregohen edhe me numrin e orëve të punës e cila shprehet në tabelën e mëposhtme e krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak 2023. Orët e punës tregojnë edhe mundësinë e gjenerimit të energjisë, përkundër dallimeve në prodhim nga procesi i ndalesave të paplanifikuara.

Orët e punës në dispozicion	Viti 2024	Viti 2023	Ndryshimi viti 2024 vs 2023
A3	5,376	5,412	(0.67)
A4	5,509	6,617	(16.74)
A5	6,120	4,529	35.12
B1	7,587	6,098	24.43
B2	7,310	6,223	17.47



Megjithatë, duhet të theksohet se KEK ka arritur të mbajë performancën e prodhimit në nivele optimale, ndërkohë që kriza energjetike në tregun ndërkombëtar ka vazhduar të ndikojë në sigurinë e operimeve të KEK-ut përmes efekteve që ajo ka në zingjirin furnizues. Për të përmirësuar këtë situatë, KEK-u duhet të krijojë plane afatgjata për të përmirësuar ecurinë e investimeve kapitale dhe në prodhimin e energjisë nga burime vendore, sidomos me rritjen e prodhimit të energjisë së ripërtrishme. Në këtë mënyrë, KEK-u mund të ndihmojë në përmirësimin e stabilitetit të energjisë dhe në rritjen e vetëbesimit të qytetarëve dhe industrisë në sistemin energjetik të vendit.

## Divizioni i Mihjeve

Roli i Divizionit të prodhimit të qymyrit është furnizimi në vazhdimësi i Termocentraleve me qymyr me sasi dhe cilësi të lartë në bazë të kapaciteteve të pajisjeve ekzistuese, të bazuara në kosto sa më të ulët të operimit dhe në ngritje të produktivitetit të prodhimit, në respektimin e bazës ligjore dhe rregulloreve në fuqi për sigurinë e Mihjes, personelit dhe pajisjeve të DPQ-së.

Rol më rëndësi për DPQ-në është mbajta e nivelit të rezervave të thëngjillit brenda kufirit për TCA- 80,000-250,000 ton, ndërsa për TCB-130,000-360,000 ton rezerva në depo.

Si pjesë e Planit të Biznesit 2024, Divizioni i Mihjeve kishte për objektiv prodhimin e 9 milionë ton thëngjill dhe 13.25 milionë m<sup>3</sup> djerrinë. Për implementimin e këtij plani në shërbim ishin lokacionet si Sibovci Jug- Perëndimor.

Siç shihet në Tabelën 1, prodhimi i thëngjillit për vitin 2024 ka qenë 8,106,057 ton apo 9.93% më e ulët se sa ishte planifikuar. Kurse në segmentin e Djerrinës janë prodhuar 10,538,915 m<sup>3</sup> apo 20.36% është më pak se plani vjetor i 2024 duke qenë e mjaftueshme furnizimi me thëngjill për nevojat e TC-ve.

Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit paraprak 2023, në segmentin e prodhimit të qymyrit ka një rritje të prodhimit të qymyrit për **17.08 %** dhe po ashtu rritje në prodhimin e Djerrinës për **2.25 %**.

Indikatori Kyç i Performances Sibovci J.P.	viti 2024				viti 2023			viti 2024/ viti 2023		
	Njësi	Plani	Realizimi	%	Plani	Realizimi	%	Realizim 2024	Realizimi 2023	%
Prodhimi i Qymyrit	tone	9,000,000	8,106,057	90.07	8,300,000	6,923,659	83.42	8,106,057	6,923,659	<b>117.08</b>
Prodhimi i Djerrinës	m3	13,233,340	10,538,915	<b>79.64</b>	14,533,000	10,306,590	<b>70.92</b>	10,538,915	10,306,590	<b>102.25</b>

**Tabela 1 - Divizioni i Mihjeve 2024-2023**  
Indikatorët Kyç të Performancës, Plani dhe Realizimi

Në tabelën e lartë paraqitur (Tabela 1) vërehen disa shmangie në realizim. Ky realizim dhe përafrim i planit të prodhimit të qymyrit në raport me atë të parashikuar, është për shkak të ngritjes së efikasitetit dhe produktivitetit në punë dhe investimeve të vazhdueshme në pajisje dhe kapacitete prodhuese.



Prodhimi i Djerrinës (nga Tabela 1) në total kishte realizueshmëri prej 79.18%, dhe qëllimi i Divizionit të Mihjeve ishte që të zhvendoset sa më shumë djerrinë nga Sibovci Jug-Perëndimor dhe të zbulohen rezerva të mjaftueshme në atë pjesë mirëpo mos arritja e planit të paraparë është si rezultat i mos realizimit të orëve të planifikuara për të gjitha sistemet e djerrinës, ku nga 16,191 h të planifikuara janë realizuar 11,600 h efektive, shprehur në përqindje 72 % si dhe për shkak të mungesës së stafit punonjës dhe kushteve atmosferike , të cilat kanë ndikuar në rritjen e numrit të vullkanizimeve ku ka pas ndalesa të sistemeve, ndërsa prodhimi i qymyrit ishte në vijë me planin dhe e mjaftueshme për kërkesat e njësive gjeneruese.

### **Divizioni i Gjenerimit**

Prodhimi i energjisë elektrike është kompetence e Divizionit të Gjenerimit. Divizioni i Gjenerimit të Energjisë Elektrike përbëhet nga Termocentralet Kosova A me 5 Njësi Punuese, prej tyre janë funksionale 3 Njësi Punuese A-3,A-4,A-5 dhe Termocentralet Kosova B me 2 Njësi Punuese B-1 dhe B-2.

Roli i Divizionit të Gjenerimit është prodhimi i energjisë elektrike në termocentrale me kosto sa më të ulët të mundshme, në mënyrë që t'i plotësoj nevojat e prodhimit të planifikuar për konsum për tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Për Divizionin e Gjenerimit, viti 2024 ka qenë periudhë e mirë, dhe se indikatorët kryesor (Prodhimi i Energjisë Neto) tregojnë se është përmbushur përafërsisht plani i prodhimit nga të dhënat në Tabelën me poshtë ku paraqitet plani i prodhimit të termocentraleve në Divizionin e Gjenerimit të cilat kanë operuar me sukses në prodhimin e energjisë elektrike. Për vitin 2024 kemi mos përmbushje të planit të prodhimit për 93.3% apo 6.7% më e ultë se atë të planifikuar, ndërsa krahasimi i njëjtës periudhë viti 2024 me vitin paraprak 2023 është më i lartë për 9.95 %.

Të dhënat rreth realizimit të prodhimit të energjisë dhe krahasimit në % të periudhave të njëjta viti 2024 dhe viti 2023 janë paraqitur në tabelën më poshtë:

Realizimi i Prodhimit Neto ne TC	viti 2024				viti 2023			viti 2024/viti 2023		
	Njësi	Plani	Realizimi	%	Plani	Realizimi	%	Realiz. 2024	Realiz.2023	%
Prodhimi A3	MWh	696,000	638,465	91.7	879,000	676,648	76.98	638,465	676,648	94.36
Prodhimi A4	MWh	726,000	625,154	86.1	858,000	825,097	96.17	625,154	825,097	75.77
Prodhimi A5	MWh	737,775	701,082	95.0	703,080	555,047	78.95	701,082	555,047	126.31
Prodhimi B1	MWh	1,842,000	1,825,628	99.1	1,530,864	1,471,336	96.11	1,825,628	1,471,336	124.08
Prodhimi B2	MWh	1,890,000	1,732,087	91.6	1,469,400	1,476,883	100.51	1,732,087	1,476,883	117.28
<b>Total</b>	<b>MWh</b>	<b>5,891,775</b>	<b>5,494,964</b>	<b>93.3</b>	<b>5,440,344</b>	<b>4,998,201</b>	<b>91.87</b>	<b>5,494,964</b>	<b>4,997,785</b>	<b>109.95</b>

**Tabela 2 - Divizioni i Gjenerimit 2024-2023**  
Indikatorët Kyç të Performancës, Plani dhe Realizimi



## Prodhimi në TCB

Realizimi i prodhimit të energjisë elektrike në raport me prodhimin e energjisë së planifikuar në të dy gjeneratorët e TC Kosova B, për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2024 është **95.33 %**. Kjo përqindje paraqet realizimin e planit me MW të reduktuar nga dispeçeri, ndërsa mos-përmbushja e planifikuar është për arsye të ndalesave të paplanifikuara si dhe investimet e nevojshme në Njësi. Kurse, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak 2023 është më i lartë për 20.67 %.

Të dhënat rreth realizimit të prodhimit të energjisë dhe krahasimit në % të periudhave të njëjta viti 2024 dhe viti 2023 janë paraqitur në tabelën më poshtë:

Realizimi i Prodhimit Neto ne TCB	viti 2024				viti 2023			viti 2024/ viti 2023		
	Njësi	Plani	Realizimi	Variacioni ne %	Plani	Realizimi	Variacioni ne %	Realizim 2024	Realizimi 2023	Variacioni ne %
Prodhimi B1	MWh	1,842,000	1,825,628	99.11	1,530,864	1,471,336	96.11	1,825,628	1,471,336	124.08
Prodhimi B2	MWh	1,890,000	1,732,087	91.64	1,469,400	1,476,883	100.51	1,732,087	1,476,883	117.28
Total B1+B2	MWh	3,732,000	3,557,715	95.33	3,000,264	2,948,219	98.27	3,557,715	2,948,219	120.67

**Tabela 3 - Divizioni i TCB 2024-2023**  
Indikatorët Kyç të Performancës, Plani dhe Realizimi

## Prodhimi në TCA

Realizimi i prodhimit të energjisë elektrike, në të tri gjeneratorët e TC "Kosova A" për vitin 2024 është **89.7 %**. Kjo përqindje paraqet realizimin e planit me MW-të e reduktuar nga dispeçeri, mos përmbushja e planifikuar është për arsye të revizionimit të njësive si dhe ndalesave të detyrueshme për intervenime e nevojshme në funksionalitetin e njësive, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak 2023 është më i ultë për **6.48 %**.

Realizimi i Prodhimit Neto ne TCA	viti 2024				viti 2023			viti 2024/viti 2023		
	Njësi	Plani	Realizimi	%	Plani	Realizimi	%	Realiz. 2024	Realiz.2023	%
Prodhimi A3	MWh	696,000	638,465	91.7	879,000	676,648	76.98	638,465	676,648	94.36
Prodhimi A4	MWh	726,000	625,154	86.1	858,000	825,097	96.17	625,154	825,097	75.77
Prodhimi A5	MWh	737,775	701,082	95.0	703,080	555,047	78.95	701,082	555,047	126.31
Total A3+A4+A5	MWh	2,159,775	1,937,249	89.7	2,440,080	2,049,982	84.01	1,937,249	2,049,566	94.52

**Tabela 3 - Divizioni i TCA 2024-2023**  
Indikatorët Kyç të Performancës, Plani dhe Realizimi



## Monitorimi Mjedisit

Gjatë kësaj periudhe, janë përgatitur dhe dërguar rregullisht në MMPHI dhe Komunë të Obilqit raportet periodike mujore dhe vjetore, ku janë përfshirë të dhënat bazë që rezultojnë nga monitorimi i mjedisit, si dhe janë paraqitur çështjet që kanë të bëjnë me mjedisin në KEK. Me këtë rast, aty janë paraqitur shënimet monitoruese integrale të tërë sistemit, duke filluar nga lënda e parë, prodhimi dhe shfrytëzimi i qymyrit, prodhimi i energjisë elektrike dhe efektet në mjedis.

Pas një periudhe të kaluar me dinamikë të zvogëluar për shkak të kushteve të motit, kanë vazhduar aktivitetet në terren rreth inspektimeve të rregullta që kanë të bëjnë me çështje mjedisore në njësi prodhuese brenda KEK-ut.

Gjatë kësaj periudhe grupi i matjeve të aftësuar nga JICA dhe IHMK , kanë filluar matjet në mënyrë të pavarur brenda KEK-ut me pajisjet e pranuar si donacion nga JICA për matjen e emisioneve të pluhurit dhe gazrave nga oxhaqet e Termocentraleve .

Rezultatet e monitorimit të emisioneve (shkarkimeve) të pluhurit dhe gazrave nga Termocentralet, për vitin 2024 janë të paraqitura me poshtë:

Njësit	Përlogaritja e emisioneve për vitin 2024						
	Bruto gjenerimi i realizuar i EE ( MWh)	Thëngjilli i shpenzuar (t)	Prodhiimi i hirit (t) Mes. 0.23 (t/Mw)	SO <sub>2</sub> (kg) Mes. 2.67 (kg/Mwh)	NO <sub>x</sub> (kg) Mes.3.04 (kg/MWh)	CO <sub>2</sub> (kg) Mes. 1328 (kg/MWh)	Emetimi i grimcave të pluhurit t(kg) Mes.0.30 (kg/MWh)
TCA	2,221,294.89 (MWh)	3,184,966(t/muj)	514,410 (t/muj)	5,326,297.11 (kg/Mwh) 5,326.30 (t/muj)	6,835,059.50 (kg/Mwh) 6,835.06 (t/muj)	2,967,793,349.60 (kg/Mwh) 2,967,793.35 (t/muj)	654.31(t/muj)
TCB	3,957,078.00(MWh)	5,009,171.00 (t/ muj)	717,813.00 (t/ muj)	6,362,850.15 (kg/Mwh) 6,362.85 (t/muj)	10,017,045.20 (kg/Mwh) 10,017.05 (t/muj)	4,712,343,010 (kg/Mwh) 4,712,343.01 (t/muj)	4,945.53 (t/muj)

## Burimet Njerëzore

Nisur nga të dhënat e Departamentit të Burimeve Njerëzore, në Korporatën Energjetike të Kosovës në fillim të muajit Janar 2024 kanë qenë të punësuar gjithsej 3,323 punonjës; prej tyre 347 Punëtorë të rinjë (këtu hyjnë edhe punëtorët që kthehen nga pushimi pa pagesë), 133 punëtorë kanë bërë transfere, 9 vendime për ndërprerje të marrëdhënies së punës nga i punësuar (me vetë dëshirë), 2 ndërprerje të marrëdhënies së punës me marrëveshje, 17 vendime vdekjeje, 192 vendime për ndërprerje (mosha 65 vjeçare), 2 vendime skadim i kontratës së punës, 13 vendime për ndërprerje të marrëdhënies së punës (masa disiplinore, mungesë nga puna, etj) dhe 5 vendime pushim pa pagesë. Bazuar në të dhënat e cekura konstatohet se në fund të muajit Dhjetor 2024 kemi të punësuar gjithsej 3,448 punonjës.

Prandaj në bazë të nevojave të korporatës, trendeve të kaluara në ndryshimin e numrit të stafit dhe në përputhje me qëllimet e korporatës të cilat janë buxhetuar në vitin 2025 do të vazhdohet me procese të reja të rekrutimit të stafit.



Qendra e trajnimeve e cila operon në kuadër të KEK-ut, zhvillon trajnime sipas planit dhe sipas kërkesës së njësive operuese dhe të administratës së KEK-ut. Por qendra kryen edhe trajnime sipas kërkesave nga operatorë të jashtëm. Gjatë vitit janë zhvilluar programe të ndryshme trajnimi për 599 kandidatë të trajnuar (jashtë KEK-ut numri i të trajnuarve ishte 118 kandidatë) me 386 ditë trajnimi. Lëndët e trajnimeve ishin të fushave të ndryshme duke përfshirë lëmitë e sigurisë në punë, teknologjisë së saldimit, teknologjisë mekanike, xehetarisë dhe elektrike si dhe menaxhim dhe administrim.

## **Performanca Financiare dhe Rezultatet**

Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) vazhdon të operojë me performancë të lartë financiare edhe në vitin 2024. Problemet e shfaqura në procesin e prodhimit, për shkak të operimit me pajisje të vjetra, ka ndikuar në performancën financiare, duke rritur kostot e importit dhe jobalancave. Megjithatë, KEK vazhdon të krijojë parakushte për investime që synojnë rritjen e stabilitetit në prodhimin e qymyrit dhe energjisë në të ardhmen, duke u mbështetur në burime të brendshme financimi. Gjendja financiare e kompanisë paraqitet në draft pasqyrat financiare të bashkëngjitura në aneks të këtij raporti, të cilat janë përmbledhur në vijim:

**Analiza e kësaj performancë është bërë në bazë të Draft Pasqyrave Financiare të cilat do të finalizohen vetëm pas auditimit të pavarur të tyre.**

## **Gjendja e Kompanisë dhe krahasimet me vitin 2023**

Siç shihet në draft pasqyrat financiare, korporata ka një gjendje të mirë financiare duke rritur vlerën e aseteve të kompanisë vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2024 në shumë prej €11,21 milionë, e shprehur në rritje të përqindjes prej 1.85% më e lartë. Vlera totale e aseteve me 31.12.2024 është €615,553 milionë, ndërsa me 31.12.2023 është €604,345 milionë.

**Asetet Jo qarkulluese** kapin vlerën e € 315.74 milion, të paraqitura në vlerën neto të tyre, të rritur për vlerën e investimeve dhe të zvogëluara për zhvlerësimin. Dalja e parasë për investime ishte € 41.99 milion. Asetet jo-qarkulluese janë më të larta për 28.35% ose në vlerë €66,22 milion e cila paraqet rritjen e investimeve të KEK-ut në depozita afatgjatë si dhe investimet në asetet kryesore të kompanisë.

### **Asetet Qarkulluese**

**Stoqet (inventarët )** janë zvogëluar në € 0.34 milion ose 1.81% krahasuar me vitin paraprak, duke qenë në përputhje me politikat dhe nevojat e kompanisë para fillimit të investimeve kapitale.

**Paraja e gatshme në banka**, kap vlerën € 2.639 milion në fund vitin 2024, e zvogëluar për 94.52 % krahasuar me periudhën e vitit paraprak. Ndryshimi i atribuohet ndryshimit të çasjes së kompanisë ndaj parave të gatshme të mbajtura, konkretisht investimet në depozita afatshkurtra kapin vlerën € 195 milion si dhe depozitat afatgjatë 48 milion €. Po ashtu ndikim kanë pasur edhe gjendja e llogarive të arkëtueshme si dhe nga performanca financiare e periudhës, e shoqëruar nga mosrealizimi i investimeve të planifikuara.



**Llogaritë e Arkëtueshme tregtare**, paraqitura me vlerën neto të realizueshme janë rritur për 11.56% ose € 4.3 milion, duke kapur vlerën € 41.92 milion.

**Kërkesat tjera duke përfshi avanset per furnitor dhe Parapagimet** janë rritur për 100.42% ose € 20.17 milion. Rritja e konsiderueshme në tek parapagimet është si rezultat i pagesave avans të realizuara për projektin kapital të modernizimin e turbinave të bllokut B1 dhe B2.

**Fitimi/Humbjet e akumuluar** - KEK ka fitime të akumuluar gjatë viteve duke e ndryshuar strukturën e kapitalit të aksionarit në kompani. Fitimet e mbajtura me 31 Dhjetor 2024 kapin vlerën 165.16 milion €.

**Ekuiteti i aksionarëve** i cili paraqet interesin e aksionarëve në kompani, është rritur në fund të vitit 2024 në € 418.25 milion nga € 378.12 milion, sa ishte në fund të vitit 2023.

**Detyrimet afatgjata** kapin vlerën €164.49 milion, të cilat kanë një zvogëlim të vogël dhe kryesisht për vlerën e kthyer të huamarrjes afatgjatë, ndërsa në total detyrimet afatgjata janë më të vogla për € 11.77 milion, në raport me vitin 2023.

**Detyrimet Afatshkurtra** në vlerë € 32.81 milion, janë më të ulëta për € 17.1 milion krahasuar me vitin paraprak, kryesisht për shkak të granteve të shtyera për import të energjisë elektrike të kthyera (paguara) në vlerë € 16.19 milion.

### **Pasqyra e të hyrave dhe krahasimet me vitin 2023**

Siç shihet në draft pasqyrat financiare, korporata ka regjistruar një rezultat neto pozitiv për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2024 në shumë prej €39.12 milionë. Fitimi i krijuar është si rrjedhojë e shpenzimeve më të ulëta në raport me të hyrat e Korporatës.

Kompania për vitin 2024 nuk ka marrë grante nga Qeveria. Ndërsa të hyrat nga grantet e shtyra janë 1.71 milion.

Të hyrat operative totale të realizuara për vitin 2024 janë në shumë prej €212.84 milionë dhe janë më të larta për €19.69 milionë krahasuar me vitin 2023 ose shprehur në përqindje 10.19% më e lartë krahasuar me vitin paraprak 2023. Kjo rritje e të hyrave është si pasojë e rritjes së shitjes së të hyrave nga shitjet e rrymës dhe të hyrave tjera në raport me vitin paraprak.

Duke analizuar më në detaje, janë këto të hyra:

- Të hyrat nga veprimtaria për këtë vit janë realizuar në shumë prej € 195.68 milionë nga € 180.82 milionë kundrejt një viti më parë me një rritje prej 8.21% ose € 14.85 milionë më shumë.
- Të hyrat nga grantet janë realizuar këtë vit në shumë prej € 1.71 milionë kundrejt një viti më parë me një ulje prej 85.15% ose € 9.84 milionë .
- Të hyrat tjera janë realizuar këtë vit në shumë prej € 15.44 milionë kundrejt një viti më parë me një rritje prej € 14.68 milionë, kjo kryesisht për kthimin e mjeteve nga Administrata Tatimore e Kosovës në vlerë 13.9 milion.



## Pasqyra e shpenzimeve dhe krahasimet me vitin 2023

Gjithsej shpenzimet operative për vitin 2024 janë realizuar në shumë prej €174.49 milionë e që krahasuar me € 179.83 milionë të vitit paraprak janë më të ulëta për €5.34 milionë apo shprehur në përqindje 2.97% më e ulët se në vitin paraprak.

- Shpenzimet e personelit, arrin në € 50.85 milionë në vitin 2024, nga € 48.03 milionë të vitit 2023, pra janë më të larta për rreth €2.86 milionë për shkak të rritjes së numrit të punonjësve si dhe rritjes së pagave.
- Shpenzimet e energjisë elektrike dhe komunalit në vitin 2024 arritën në € 33.04 milionë dhe janë më të ulëta krahasuar me vitin paraprak për €4.54 milionë.
- Shpenzimet për materiale dhe furnizime në vitin 2024 arritën në € 3.1 milionë dhe janë më të larta krahasuar me vitin paraprak për €0.20 milionë.
- Shpenzimet e linjitit në vitin 2024 arritën në € 24.32 milionë dhe janë më të larta krahasuar me vitin paraprak për €3.10 milionë për shkak të rritjes së prodhimit të thëngjillit krahasuar me vitin paraprak.
- Shpenzimet tjera operative janë realizuar në shumë prej €6.28 milionë apo rreth €3.4 milionë më të ulëta se në vitin paraprak.

Pra në përgjithësi shpenzimet operative kryesisht kanë një ulje nga viti paraprak përveç pjesës së shpenzimeve të personelit dhe shpenzimeve të linjitit.

## Realizimi i Buxhetit në vitin 2024

Megjithëse në vitin 2024 KEK-u e ka më të vogël realizimin e buxhetit vjetor, i lidhur me remontet kapitale të njësive dhe realizimin e projekteve kryesore të investimeve në KEK, të cilat janë të ndërlidhura me BVEE, realizimi i buxhetit për periudhën në krahasim me planifikimin vjetor paraqitet në tabelën në vijim:

Buxheti sipas rrjedhës së parësë viti 2024			
Në '000 €	Kapitale	Operative	Total
Planifikim	126.5	164.7	291.20
Realizim	42.18	169.1	211.28
Variacioni në %	33.34	102.67	72.55

Megjithëse me një ecure më të mirë se vitin e kaluar, edhe në këtë vit ka ngecje në raport me realizimin e buxhetit. Sipas të dhënave të buxhetit, KEK-u ka realizuar përafërsisht 74.58 % të buxhetit total, ndërsa buxheti i planifikuar për investime kapitale ishte realizuar 35.56%.



**KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.**  
**Pasqyra e Pozicionit Financiar**  
**Më 31 Dhjetor 2024**

	Më 31 Dhjetor 2024 (në EUR '000)	Më 31 Dhjetor 2023 (në EUR '000)
<b>PASURITË</b>		
<b>Pasuritë afatgjata</b>		
Prona, impiantet dhe pajisjet	267,524	273,733
Depozitat ne banka - pjesa afatgjate	48,000	80,621
Investimet ne letra me vlere- afatgjate	-	16,012
Asetet e paprekshme	220	386
<b>Gjithsej Pasuritë afatgjata</b>	<b>315,744</b>	<b>370,752</b>
<b>Pasuritë afatshkurtra</b>		
Stoqet	19,606	19,257
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera,neto	82,187	57,658
Paraja në dorë dhe në bankë	2,639	48,365
Depozitat ne banka - pjesa afatshkurter	169,005	73,406
Investimet ne letra me vlere- afatshkurter	26,063	34,907
Asetet e tatimit te shtyre	309	-
<b>Gjithsej Pasuritë afatshkurtra</b>	<b>299,809</b>	<b>233,593</b>
<b>GJITHSEJ PASURITË</b>	<b>615,553</b>	<b>604,345</b>
<b>EKUITETI DHE DETYRIMET</b>		
<b>Ekuiteti i aksionarëve</b>		
Kapitali aksionar	25	25
Rezervat	208,338	207,407
Rezervat rivleresuese	44,728	44,728
Fitimet/(Humbjet) e akumuluar	165,163	125,961
<b>Gjithsej ekuiteti i aksionarëve</b>	<b>418,254</b>	<b>378,121</b>
<b>Detyrimet</b>		
<b>Detyrimet jo-qarkulluese</b>		
Huamarrjet – pjesa afatgjatë	94,841	103,992
Grantet e shtyera	4,333	6,049
Provizionet	58,665	57,945
Detyrimet e shtyera tatimore	6,647	8,275
<b>Detyrimet qarkulluese</b>	<b>164,486</b>	<b>176,261</b>
Huazimet – pjesa afatshkurtër	9,699	11,996
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera	14,959	13,870
Tatimi ne te ardhura i pagueshem	1,539	835
Grantet e shtyra importi i energjise	-	16,199
Te pagueshmet e shtyera të prodhimit të energjisë	100	1,609
Shpenzimet akruale	6,516	5,454
<b>Gjithsej Detyrimet</b>	<b>32,813</b>	<b>49,963</b>
<b>GJITHSEJ EKUITETI DHE DETYRIMET</b>	<b>197,299</b>	<b>226,224</b>
	<b>615,553</b>	<b>604,345</b>



**KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.**  
**Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse**  
**Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024**

	Shënimet	Viti i përfunduar 31 Dhjetor 2024 (në EUR '000)	Viti i përfunduar 31 Dhjetor 2023 (në EUR '000)
Të hyrat nga shitja e rrymës	18	195,682	180,824
Të hyrat nga grantet	19	1,717	11,559
Të hyrat tjera	20	15,440	767
		<b>212,839</b>	<b>193,150</b>
<b>SHPENZIMET OPERATIVE</b>			
Zhvlerësimi dhe amortizimi	4,5	(48,341)	(47,808)
Shpenzimet e personelit	21	(50,850)	(48,033)
Energjia elektrike dhe komunalitë	22	(33,046)	(37,595)
Shpenzimet e mirëmbajtjes		(3,110)	(2,902)
Materialet dhe furnizimet		(4,556)	(7,316)
Shpenzimet e linjtit	17	(24,324)	(21,225)
Provizionimet për shlyerjen e inventarit	6	935	3,122
Humbjet nga zhvlerësimi/Lirimi i të arkëtueshmeve tregtare dhe të tjera		(2,708)	(972)
Ndryshimet në provizione	15	(3,722)	(3,454)
Shpenzimet e shtyera të prodhimit të energjisë		1,509	(3,922)
Shpenzimet e tjera operative	23	(6,282)	(9,727)
		<b>(174,495)</b>	<b>(179,832)</b>
<b>Fitimi nga operacionet</b>		<b>38,344</b>	<b>13,318</b>
Te hyrat / (Shpenzimet) financiare, neto	24	5,752	3,002
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>44,096</b>	<b>16,320</b>
Shpenzimet e tatimit në fitim	25	(4,972)	(4,000)
<b>Fitimi neto për vitin</b>		<b>39,124</b>	<b>12,320</b>
<b>Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse për vitin</b>			
Efekti i tatimit të shtyer në Huazimet - pjesa afatgjatë rivlerësimin e pronës, impianteve dhe pajisjeve	26	931	628
<b>Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>40,055</b>	<b>12,948</b>

**KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS SH.A.**  
**Paqyra e ndryshimeve në Ekuistet**  
**Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024**

	Kapitali aksionar (në EUR' 000)	Rezervat (në EUR' 000)	Fitimet / (Humbjet) e akumuluar (në EUR' 000)	Rezerva e rivleresimit (në EUR' 000)	Gjithsej (në EUR' 000)
<b>Gjendja më 01 Janar 2023</b>	25	198,472	113,932		312,429
Fitimi për vitin			12,320		12,320
Korrigjimet e gabimeve			(291)		(291)
Fitimi i demtimit		8,307			8,307
Rezerva e rivleresimit				44,728	44,728
Te ardhurat tjera gjithëpërfshirëse		628			628
<b>Total te hyra tjera gjithëpërfshirëse</b>		8,935	12,029	44,728	65,692
<b>Gjendja Me 31 Dhjetor, 2023</b>	25	207,407	125,961	44,728	378,121
<b>Gjendja me 01 Janar 2024</b>	25	207,407	125,961	44,728	378,121
Fitimi për vitin			39,124		39,124
Korrigjimet e gabimeve			78		78
Te ardhurat tjera gjithëpërfshirëse		931			931
<b>Total te hyra tjera gjithëpërfshirëse</b>		931	39,202	-	40,133
<b>Gjendja Me 31 Dhjetor, 2024</b>	25	208,338	165,163	44,728	418,254



# KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.

Pasqyra e rrjedhës së parasë

Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024

		Për vitin e mbyllur më 31.12.2024 (në EUR '000)	Për vitin e mbyllur më 31.12.2023 (në EUR '000)
Shënimet			
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative</b>			
Fitimi neto para tatimit		44,096	16,320
Rregullimet për zërat jomonetar			
Zhvlerësimi dhe amortizimi	4,5	48,341	47,808
Amortizimi i granteve	19	(1,717)	(11,559)
Të hyrat nga interesi	24	(9,478)	(6,964)
Shpenzimet e interesit	24	3,726	2,967
Provizionimi i borxheve të këqija	15	2,708	972
Provizionet për investime financiare		83	(293)
Provizionimi për kostot e mjedisit dhe pensione	15	3,722	3,454
Provizionimi për shlyerjet/kthimet e inventarëve	6	(935)	(3,122)
Rregullimi për energjinë e shkëmbyer		(1,509)	(1,626)
Pagesat e provizioneve gjyqesore		(2,483)	-
Shlyerja e pronës, impianteve dhe paisjeve	4,5	22	65
<b>Fitimi para ndryshimeve në pasuritë dhe detyrimet operative</b>		<b>86,576</b>	<b>48,022</b>
Inventarët		585	4,696
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera		(27,237)	23,277
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera		2,091	(8,749)
<b>Paraja e gjeneruar nga aktivitetet operative</b>		<b>62,015</b>	<b>67,246</b>
Interesi i arkëtuar		5,165	4,205
Interesi i paguar		(2,821)	(3,034)
Tatimi mbi të ardhura të paguar		(5,312)	(11,670)
<b>Paraja neto e gjeneruar nga aktivitetet operative</b>		<b>59,047</b>	<b>56,747</b>
<b>Paraja nga aktivitetet investive</b>			
Blerja e pronës, impianteve dhe pajisjeve dhe pasurive të paprekshme	4,5	(41,988)	(35,592)
Zvogëlim/(Rritje) në letra me vlerë		24,856	
Zvogëlim/(Rritje) në depozita		(60,000)	(58,529)
<b>Paraja (e përdorur) në aktivitetet investive</b>		<b>(77,132)</b>	<b>(94,121)</b>
<b>Paraja nga aktivitetet financiare</b>			
Grantet e pranuar / (paguar) për importin e energjisë	14.1	(16,253)	-
Pagesa e huazimeve	13	(11,388)	(11,388)
<b>Paraja (e përdorur) në aktivitetet financiare</b>		<b>(27,641)</b>	<b>(11,388)</b>
<b>Ndryshimi neto në para dhe ekuivalentët e parasë</b>		<b>(45,725)</b>	<b>(48,762)</b>
<b>Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit</b>		<b>48,364</b>	<b>97,127</b>
<b>Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit</b>	8	<b>2,639</b>	<b>48,365</b>



## Shpenzimet kapitale dhe projektet

Projektet kanë vazhduar me dinamikë racionale. Shpenzimet kapitale për vitin 2024 kanë shënuar rritje prej €6.57 milionë në krahasim me vitin paraprak. Të gjitha investimet në këtë periudhë janë realizuar nga mjetet vetanake të KEK-ut dhe nuk ka pasur financim nga huat.

Shpenzimet për investime kapitale të financuara nga KEK-u sipas divizioneve për periudhën raportuese janë të paraqitura si më poshtë.

## Divizioni i Mihjeve

Gjate vitit 2024, në Divizionin e Mihjeve shpenzimet kapitale kanë qenë të buxhetuara në vlerë 66.59 milion ndërsa janë realizuar 35.74 milion apo 53.67%.

Lista e shpenzimeve kryesore për këtë divizion është si vijon:

- Përvetësimi i tokave, € 30.24 milion.
- Vendosja e murit mbrojtës për gjatë rrugës së asfaltuar Seperacioni "A"(projekti i ndaljes së zhurmës dhe mbrojtjes së banorëve nga pluhuri), € 0.19 milion.
- Furnizim me ngasje të reja për pozicionet 05 dhe 09 për shiritat furnizues të TCA (reduktor, tambur, elektromotorë, bazament, xhunta hidrodinamike), € 0.29 milion.
- Komplet sistemi i lubrifikimit qendror me yndyrë për E-9B, € 0.30 milion.
- Riparimi i Konvejerit D3-2 B=18000mm, €0.44 milion.
- Pjesë rezervë për Esha, € 0.44 milion.
- Furnizim me lidhëse elastike Ø 500mm dhe Ø 710mm, € 0.03 milion.
- Furnizim me xhunta hidrodinamike për sist.S7 dhe TML-AB, € 0.10 milion.
- Shirit Gome, € 1.94 milion.
- Motor për Buldozer Caterpillar, € 0.13 milion.
- Pjesë ndërrimi për mekanizmin IVECO, € 0.03 milion.
- Pjesë ndërrimi për mekanizmin Liebherr, € 0.20 milion.
- Pjesë ndërrimi për mekanizmin Komatsu, € 0.21 milion.
- Rimork transportues me kamion, € 0.31 milion.

Projektet tjera të realizuara dhe realizimi të cilat priten gjatë vitit 2025.

- Furnizim me shëndrrues të frekuencave, € 0.13 milion.
- Furnizim me kamion-Damper, € 0.77 milion.
- Furnizim me Reduktor të transportit për SRs 470, € 0.33 milion.
- Furnizim me rule, € 1.10 milion.

Për sqarim, dinamika e punës rreth përfundimit tek disa projekte mund të mos përfundojë brenda vitit dhe të vazhdojë në vitin vijues.



## Divizioni i Gjenerimit të Energjisë

Gjate vitit 2024, në Divizionin e Gjenerimit të Energjisë shpenzimet kapitale kanë qenë të buxhetuara në vlerë 54.27 milion ndërsa janë realizuar 6.93 milion apo 11.23%.

Lista e shpenzimeve kryesore për këtë divizion është si vijon:

- Trafo T35,220/6.3KV- TCA, € 1.00 milion.
- Ndërrimi i tri tufave të nxemsave, rexhenenarativ Nr.4-TCA, €0.23 milion.
- Furnizimi me pajisjet elektrike gjenerator–zgjuës A5-TCA, € 0.23 milion.
- Furnizim me pjesë rezervë për sistemin e kaldajës blloku A3/A4/A5 siç janë: Gypat, llamarina, valvat, pjesët e valvave, pjesët e ventilatorëve, pjesët e mullinjve, pjesët e dhënsave të thëngjillit, pjesët e kracerit, pjesët e rostit, fryrërsat e blözës-TCA, € 2.00 milion.
- Materialet elektrike investive: Kontaktor, rele, ndërprerësa 6.3kV. kabllot energjetike 0.4kV, 6.3kV, monitor për filtera, bateri, ridrejtuës dhe ormana të kompletuar-TCA, €0.40 milion.
- Mirëmbajtja Investive e MRRK-së: Transmittera, termometra, manometra pjesë për PLC, AUMA, kablo, rele, senzora dhe dhënësia të sinjalit TCA, € 0.45 milion.
- Pjesë Investive në paisjet e makinerisë në objektet e jashtme-TCA € 0.40 milion.
- Furnizim me motor 6.3kV-TCB, € 0.30 milion.
- Rehabilitimi i ndriçimit të brendshëm-TCB, € 0.05 milion.
- Valva për salla të makinave-TCB, € 0.59 milion.
- Valva për armaturën e kaldajës B1 dhe B2-TCB, € 0.31 milion.
- Furnizim me instrumente laboratorike për PKU dhe MRrK-TCB, € 0.03 milion.
- Ndërrimi i Ekonomajzerit B1dhe B2-TCB, € 1.35 milion.
- Ndërrimi i tabelave elektrike 6kV (çelijave) 2BA, 2BB në B2-TCB, € 2.70 milion.
- Ndërrimi i zbarrave (me kanal) 2BA, 2BT dhe 2BB në B2-TCB, € 0.15 milion.
- Furnizim me vinç për garazh -TCB, € 0.01 milion.
- Furnizimi dhe demontimi - montimi i dy aseteve të zbarrave të reja për statorin e gjeneratorit-TCB, € 2.25 milion.
- Blerja e transformatorit 400 MVA/24kV për bllokun B1 (1AT)-TCB, € 0.48 milion.
- Blerja e një statori dhe rotorit të ventilatorit thithës-TCB, € 0.36 milion.
- Ndërrimi i tabelave 0.4kV 2CA, 2CB dhe 2CC, € 0.85 milion.
- Ndërrimi i tejnëmësit SBT1 në B2-TCB, € 3.06 milion.
- Ndërrimi i gypave të kondensatit B1 dhe B2 -TCB, € 0.95 milion.
- Riparimi i ndërprerësve të gjeneratorëve elektrik B1 dhe B2-TCB, € 1.25 milion.
- Ndërrimi i varësive të gypave integral RA .RB dhe RC-TCB, € 0.78 milion.
- Furnizimi ,montimi dhe testimi i njehsorëve matës - TCB, € 0.10 milion.
- Rehabilitimi i kanalit kryesor të gazrave nga EKO deri te nxehësit e ajrit - TCB, € 0.44 milion.
- Rehabilitimi i dhënsave të thëngjillit në B1 dhe B2-TCB, € 0.61 milion.
- Demontimi i trafos së vjetër, Liferimi montimi dhe lëshimi në punë i trafos 2BT-TCB, € 0.93 milion.



- Modernizimi dhe riparimi i turbinave në B1 dhe B2 -TCB, € 9.16 milion.
- Shamotimi/izolimi tek kanalet ri qarkulluese dhe pllakat rrëshqitëse-TCB, € 0.30 milion.
- Ndërrimi i portave të gazrave të ftohjes dhe ajrit primar-TCB, € 1.14 milion.
- Peshore te rezervari i mazutit për kamionët e himnizimit TCB, € 0.07 milion.
- Pastrimi i sipërfaqeve ngrohëse të kaldajës -TCB, € 0.19 milion.
- Riparimi i kulmit në objektin e pranimit të mazutit-TCB, € 0.04 milion.

Një pjesë e Projekteve kapitale për Divizionin e Gjenerimit do të vazhdojnë edhe në dy vitet e ardhshme, sidomos ato në mbrojtjen e mjedisit dhe në kapacitete gjeneruese.

### **Divizioni i Shërbimeve të Korporatës**

Vlera e shpenzimeve kapitale për divizionin e shërbimeve të korporatës (që përfshin sektorin e IT-së) për vitin 2024 përfshinë kryesisht furnizime me pajisje elektronike.

### **Progresi i Projekteve Kapitale**

Investimet kapitale nuk kanë pas një realizim sipas planit. Dinamika e punës rreth kompletimit të projekteve mund të mos përfundojë brenda vitit dhe të vazhdojë në vitin vijues. Në fakt, disa projekte pritet të përfundojnë gjatë vitit 2025 dhe 2026 si projekte afat-mesme të kontraktuara nga ana e KEK-ut me operatorët ekonomik.



## Rreziqet e Korporatës

Korporata ballafaqohet me pasiguri të ndryshme në aktivitetet e veta për të siguruar realizimin e objektivave. Për këtë qëllim, sipas kërkesave të ligjit 06/L-021 për Kontrollin e brendshëm të Financave Publike,<sup>1</sup> rregulloren e MF Nr. 01/20192 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe rregulloreve të brendshme për menaxhimin e rreziqeve.

Menaxhimit të rrezikut të KEK sh.a është të sigurojë transparencë dhe informacione të mjaftueshme dhe të rëndësishme me kohë rreth vlerësimit dhe menaxhimit të rrezikut në identifikimin e ngjarjeve që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave, vlerësimin e rrezikut lidhur me mundësitë e ndodhjes dhe ndikimin si dhe veprimet ndaj rrezikut me qëllim të shmangies, transferimit, pranimit, ndarjes apo zvogëlimit të rrezikut.

Përmes zbatimit të politikës për menaxhimin e rrezikut, KEK-u synon të fuqizohet në vazhdimësi në rrugën e përmbushjes së misionit dhe objektivave afatgjata në krijimin dhe ruajtjen e vlerës ndërkohë që mbahen në minimumin e mundshëm, kostot e rrezikut për KEK-un dhe aksionarët.

Edhe pse e vendosur jo shumë kohë më parë, në mungesë të kulturës dhe traditës për menaxhimin e rreziqeve, KEK-u tashmë zhvillon një proces të menaxhimit të rreziqeve të cilat kanë të bëjnë me kërkesën ligjore për monitorimin e vazhdueshëm të pasigurive të shumta me të cilat ballafaqohet KEK, tashmë të diskutuara në shumicën e raporteve, dhe që vijnë e shpërfaqen dhe forcohen për nga rëndësia sidomos në kohë krizash si luhatje të tregjeve, kriza energjetike, etj. Procesi i menaxhimit të rreziqeve ka rëndësi edhe për përfshirjen e mundshme të rreziqeve të vlerësuara si të shmangshme, në buxhetin vjetor të KEK. Sipas ligjit nr. 06/L-021 Për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, KEK si e tërë është përgjegjëse për menaxhimin e rreziqeve kurse bartës të rreziqeve, janë personat përgjegjës të departamenteve të cilët ballafaqohen drejtpërdrejt me operimet ditore.

Vlerësimi i rrezikut i ndan ato në faktor të jashtëm që kanë ndikim në KEK dhe ato të brendshme që mund të identifikohen dhe mund të parandalohen nga vetë udhëheqësit e njëjësive dhe menaxherët.

Rreziqet e jashtme të vlerësuara e që kanë ndikim në Korporatë janë si vijon:

- Normat e interesit (ndryshimet në normat e interesit për kredit ekzistues me MEF)
- Norma e inflacionit (rritja e çmimeve të furnizimit ndikojnë në rritjen e kostos së operimit)
- Konfliktet e armatosura dhe pasiguritë politike (rritja e pasigurisë dhe vështirësitë në zingjirin furnizues)
- Ndryshimet klimatike (kërkesat për zbatimin e politikave për net-zero emetime të gazrave)
- Rreziqet e reputacionit (detyrimet për mbrojtjen dhe përmirësimin e ambientit).

<sup>1</sup> [LIGJI NR. 06/L-021 KONTROLLIN E BRENDSHËM TË FINANCIVE PUBLIKE \(rks-gov.net\)](#)



- Rreziqet e lëvizjes së çmimeve të tregut në Bursa (Tregtimi i energjisë, furnizimi me vajra dhe lëndë djegëse përcjellja e tyre nëpër muaj dhe krahasimi i tyre për shitje se në cilin periudhë çmimi është më i lartë si dhe blerje kur janë çmimet më të ulëta për furnizim).

Korporata ballafaqohet me pasiguri të ndryshme në aktivitetet e veta për të siguruar realizimin e objektivave. Menaxhimi i rrezikut të brendshëm është përgjegjësi e udhëheqësve të lartë të Korporatës dhe BOD-ve , për vendosjen e sistemit të menaxhimit të rrezikut të dokumentuar dhe përfshin identifikimin, vlerësimin dhe veprimet në zvogëlimin e rrezikut në mënyrë që të arrihen objektivat e organizatës.

### **Identifikimi i Rreziqeve**

Për ti trajtuar rreziqet fillimisht duhet ti njohim ato. Sipas ligjit 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, në nenin 8 identifikimi i rreziqeve bie mbi bartësit e tyre pra menaxherët dhe udhëheqësit e njësive.

KEK e realizon këtë përmes procesit të pyetësorëve/ formularëve të adaptuara sipas kërkesave të rregullores MF 01/2019. Në to argumentohen në nivele të ndryshme të vendimmarrjes ngjarje të mundshme të cilat mund të rrezikojnë arritjen e objektivave. Kjo përmes pyetjeve dhe analizës së situatave të mundshme se çfarë mund të ndodh, ku, kur dhe si mund të ndodh?! Si dhe kush është personi përgjegjës bartës i rrezikut. Bartësit e rrezikut janë në nivele të ndryshme personat të cilët e kanë në dorë menaxhimin e aseteve dhe/ose operimin me to.

Rreziqet e korporatës janë të grupuara sipas nivelit të vendimmarrjes në: Strategjike, financiare, Operative dhe të përputhshmërisë.

Aplikimi i procedurës për menaxhimin e rrezikut, inkurajon të menduarit afatgjatë dhe strategjik po ashtu i përgjigjet kërkesave ligjore, për identifikimin dhe menaxhimin e rrezikut e cila ndikon në cilësinë e menaxhimit si dhe në garancinë për vazhdimësinë dhe realizimin e objektivave afatgjata të Biznesit.

### **Masat për menaxhimin e rreziqeve**

Menaxhimi i rreziqeve është proces i vazhdueshëm dhe kërkon zbatimin e masave të parapara nga vetëbartësit e rreziqeve, si personat më kompetent për eliminimin e situatave të pafavorshme. Këto masa dhe afatet janë të përshkruara në regjistrin e rreziqeve.

- Rreziqet strategjike- niveli i vendimmarrjes është i Bordit të Drejtorëve dhe Menaxhmentit të lartë të korporatës. Kërkohet monitorim i shtuar për zbatimin e kërkesave për eliminimin e rreziqeve të identifikuara në këtë kategori.
- Rreziqet Financiare- përgjegjës Drejtori Financiar dhe Kryeshefi Ekzekutiv, me përkrahjen e BtD për vendimet e mëdha. Kërkohen aktivitete periodike të listuara tek identifikimi dhe regjistri i rreziqeve.
- Rreziqet operative - niveli i vendimmarrjes për menaxhimin është i menaxhmentit. Zvogëlimin e këtij grupi të rreziqeve, varen shumë nga realizimi i buxhetit në realizimin e planeve të veprimit.

- Rreziqet e pajtueshmërisë- niveli i menaxhmentit është edhe përgjegjësi e të gjithë drejtuesve në të gjitha nivelet, që të veprojnë në përputhje me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme duke ndikuar në funksionimin e mirë të kontrolleve të brendshme, të cilat pastaj ulin nivelin kritik të rreziqeve .

Realizimi i investimeve kapitale në veçanti është i lidhur me stabilitetin e prodhimit të energjisë elektrike dhe të thëngjillit, dhe si rrjedhojë ndikon në të hyrat e korporatës dhe uljen e shpenzimeve të paplanifikuara. Masat që varen nga KEK-u për të minimizuar rrezikun në mos realizim të buxhetit ndër të tjera janë:

- Inicimi me kohë i kërkesave për blerje, trajtimi me kujdes të shtuar dhe profesional i specifikimeve teknike dhe kërkesave administrative, hulumtim intensiv i tregut, trajnime për stafin e përfshirë në blerjet dhe menaxhimin e kontratave etj.
- Zbatimin me përpikëri të standardeve operues të punës dhe kërkesave teknike etj.
- Inicimi i konkurseve për angazhimin e punëtorëve dhe menaxhimi me kujdes i shpalljeve publike për angazhimin e kuadrove me kohë për përmbushjen e kërkesave urgjente për staf profesional etj.



## RAPORTIMET SHITESË PËR AKSIONARIN

### *Qeverisja korporative*

KEK operon me Bordin Drejtues si organin më të lartë vendimmarrës në korporatë. Përgjegjësitë e qeverisjes korporative bien mbi këtë organ dhe janë të rregulluara me ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe aktet tjera nënligjore. Bordi Drejtues i KEK Sha është organ i pavarur dhe profesional, i zgjedhur përmes procedurave ligjore dhe transparente nga ana e aksionarit. Ai funksionon në përbërje të plotë dhe drejton ndërmarrjen e cila operon në tregun e energjisë si ofrues i të mirës publike nën rregullat e qeverisjes korporative në përputhje me ligjet dhe aktet tjera ligjore.

Bordi është përgjegjës për përcaktimin e strategjisë së Korporatës dhe orientimet afatgjata të biznesit, drejt rritjes së vlerës së interesit të aksionarit në kompani. Funksionet e bordit përfshijnë krijimin, vlerësimin dhe mbikëqyrjen, e strategjisë së korporatës, duke marrë për bazë edhe analizën e rreziqeve me të cilat kërcënohet mos realizimi i pritjeve financiare dhe jo financiare përfshirë rreziqet sociale, mjedisore, ambientale të reputacionit dhe etikes së biznesit.

Përveç që vendos për strategjinë e biznesit, bordi ka për detyrë zgjedhjen dhe monitorimin e menaxhmentit të lartë të kompanisë, bartjen e autorizimeve dhe monitorimin. Gjatë vitit 2024 këtë funksion, bordi e ka ushtruar me mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigoroze në veçanti rreth punës dhe performancës së Zyrtarit Kryesor Administrativ, Zyrtarit Kryesor të Financave dhe Thesarit dhe Sekretarit të Ndërmarrjes (duke përjashtuar Zyrtarin e Auditorit të Brendshëm, rreth të cilit Komisioni i Auditorëve duhet të ketë kompetenca ekskluzive).

Rolin dhe detyrat e veta mbikëqyrëse Bordi i Drejtorëve e kryen përmes mekanizmave të ndryshëm. Për këtë qëllim aksionari ka emëruar komitetin e Auditimit i cili vepron në kuadër të Bordit të Drejtorëve në përputhje me kërkesat ligjore të ligjit për Ndërmarrjet Publike, dhe me praktikat më të mira të qeverisjes korporative.

Gjatë vitit 2024, bordi ka marrë një sërë vendimesh për korporatën duke përfshirë: aprovimi i strategjisë zhvillimore 2024-2028, aprovimin e Pasqyrave Financiare Vjetore për Vitin 2023, Raportin Vjetor të KEK për 2023, raportin e Rreziqeve për 2024, Rishikimin e Buxhetit për 2024 si dhe aprovimin e buxhetit afatmesëm për periudhën 2025-2027, aprovimin e Raporteve periodike dhe monitorimin e performancës së korporatës, një sërë vendimesh për ri-alokime të mjeteve buxhetore në përputhje me rregulloret e brendshme, dhe një sërë vendimesh të tjera të karakterit strategjik. Në marrjen e këtyre vendimeve bordi ka shfrytëzuar për konsultim edhe Zyrën e Auditimit të Brendshëm në kapacitetet e saja për siguridhënie përmes opinioneve për procedurat dhe rregulloret që është dashur që të aprovohen në BD përmes Komisionit të Auditimit.

Gjatë vitit 2024 Bordi i drejtorëve të KEK, me synim rritjen e kontrolleve të brendshme dhe përgjegjësinë e punonjësve të korporatës ka aprovuar rregulloret dhe procedurat në vijim:

- Politika dhe Procedura për Provizionim të inventarit me lëvizje të ngadalshme dhe të vjetërsuar
- Rregullorja për organizimin e zyre së Auditimit të brendshëm
- Rregullore për Sponsorizime dhe Donacione
- Kodin e Punës të ndryshuar
- Procedura për përgjegjësitë disiplinore
- Procedura për investimin e mjeteve financiare në afatizime bankare dhe letra me vlerë, e ndryshuar



Së fundmi, bordi i drejtorëve ka marr edhe vendime të tjera strategjike në përputhje me detyrat dhe përgjegjësit e tij në kuadër të qeverisjes korporative si: Aprovimi i inicimit për Rahabilitimin A3, Angazhimin e Auditorit të Jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare, aprovimin për rritjen e pagave për punëtorët si dhe ndarjen e bonuseve për punëtorët e KEK në bazë të performancës vjetore të realizuar nga korporata, etj.

Vendime të tjera lidhur me përgjegjësitë sociale kanë të bëjnë me sponsorizimin gjeneral të konferencës së mirënjohur për energjinë CIGRE II, dhënien e 250 ton thëngjill donacion për ngrohje për shkollat e Komunës së Obiliqit, dhëni e donacionit për shërim jashtë vendit etj.

### ***Kultura e menaxhimit të rrezikut***

Kultura e Menaxhimit të Rrezikut në Ndërmarrje (ERM) është një komponent i rëndësishëm i ndërgjegjësimit për menaxhimin pro aktiv të rrezikut në të gjitha nivelet e organizatës si dhe jetik i një strategjie gjithëpërfshirëse të menaxhimit të rrezikut. Ajo nxit një mjedis ku punonjësit jo vetëm inkurajohen por edhe pritët të identifikojnë, vlerësojnë dhe menaxhojnë rreziqet brenda fushave të tyre të përgjegjësisë. Kjo kulturë ndërtohet mbi një bazë të komunikimit të hapur, ku diskutimi i rreziqeve dhe ndikimeve të mundshme është pjesë e rrjedhës së punës së përditshme, duke siguruar që menaxhimi i rrezikut të mos jetë i izoluar nga, por i integruar në proceset e vendimmarrjes. Një kulturë efektive ERM promovon përgjegjësinë dhe përmirësimin e vazhdueshëm, duke mundësuar organizatat të parashikojnë dhe të zvogëlojnë rreziqet më efektivisht, duke mbrojtur kështu pasuritë, reputacionin dhe interesat e palëve të interesit.

Për këtë qëllim roli i Auditimit të brendshëm në rishikimin e procesit të brendshëm të menaxhimit të rrezikut është i nevojshëm edhe për të rritur kulturën organizative për këtë proces. KEK gjatë vitit 2023 kishte auditime të pjesshme të procesit, kryesisht nën Auditimin e vendimeve të BtD. Megjithatë planifikohet, që pas rishikimit të planit vjetor të ZAB ose me kërkesë të veçantë, të auditohet procesi i menaxhimit të rrezikut në KEK.

### ***Përkrahja për komunitetin***

Përkrahja për komunitetin - gjatë vitit 2024 nuk janë financuar projektet për komunitetin, kjo për arsye se projektet janë publikuar më shumë se njëherë dhe për disa nuk ka pasur fare oferta ndërsa për disa ofertat kanë qenë të pa përgjegjshme. Ndërsa, KEK si zakonisht ka vazhduar përkrahjen komunitetin dhe institucioneve të sigurisë në vend me punë dhe pajisje.

Gjatë vitit 2024 Korporata Energjetike e Kosovës ka miratuar Rregulloren për Sponsorizime dhe Donacione (nr.1326, të datës 01.03.2024 ), në bazë të së cilës komisioni ka trajtuar tri kërkesa për sponsorizime të cilat janë trajtuar dhe aktualisht janë në proces (noterial ) dhe një kërkesë për donacion, e cila ka përfunduar me sukses, por aktualisht është në pritje të garancionit bankar nga pala që e ka kërkuar donacionin.

### ***Përmbledhja e të gjitha procedurave gjyqësore ose të arbitrazhit të pambaruara***

Në Zyrën Ligjore gjatë vitit 2024 janë regjistruar gjithsejtë 248 padi (civile dhe penale) shuma e përgjithshme e të cilave sillet rreth €4.02 milionë. KEK-u ka qenë palë paditëse me lëndë. Numri i padive të palëve kundër KEK-ut arrin në 225 lëndë.



Në segmentin e aktgjykimeve gjatë vitit 2020 janë regjistruar gjithsejtë 214 të tilla (të shkallës së parë, dytë dhe supreme) prej tyre 116 kanë rezultuar në favor të KEK-ut kurse 98 në favor të palëve. Aktgjykimet që u ekzekutuan janë gjithsejtë 55 në vlerë prej 1,169,451€, te gjitha ne favor te palëve.

Departamenti i pronës, gjatë këtij viti ka bërë kompletimin e dokumentacionit sipas sugjerimeve të Departamentit të Shpronësimit pranë Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) për projektin 129 HA dhe projektin 20.58HA për parkun solar. Departamenti i pronës së bashku me departamentin e gjeodezisë kanë përgatitur elaboratin e shpronësimit me kërkesë për fillimin e procedurave të zhvendosjes së projektit 72ha dhe zonën e Hadës së Re. Gjatë periudhës 3 mujore, ky Departament ka proceduar pagesat konform vendimit përfundimtar të Qeverisë për shpronësim, dhe ndryshimin e të dhënave ne Komunën e Obiliqit, të pronave të shpronësuara dhe kompensuar si dhe ka përfaqësuar në seancat gjyqësore te rastet kur palët nuk janë pajtuar me shumat e caktuara nga Ministria e Financave në procedurë të shpronësimit.

Janë eliminuar pengesat e identifikuara në Agjencinë Kadastrale të Kosovës për disa parcela në projektin – Parku solar dhe në disa parcela në projektin 129 ha që janë identifikuar si lëshime për shkak mos përputhjes së pjesës tekstuale me atë grafike dhe kanë rezultuar me tejkalimin e tolerancave të lejuara. Departamenti i Pronës së bashku me Departamentin e Gjeodezisë të DPQ kanë marrë udhëzimet nga MMPHI dhe AKK në takimet që kemi mbajtur së bashku me Sekretarin dhe Drejtorin e ZL të KEK-ut, ku pas disa angazhimeve intensive kanë kaluar këto propozime dhe janë nxjerrë vendimet preliminare nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Në segmentin e arbitrazhit për vitin 2024 kemi një lëndë me ndërgjyqësit KEK/KEDS, e cila është iniciuar në 2023 kurse në vitin 2024 ka hy në procedurë dhe është duke vazhduar deri ne vendimin përfundimtar.

## Struktura Organizative KEK Sh.A 2024





### **Transaksionet e Konsiderueshme**

Në kuadër të këtyre transaksioneve në tabelën e mëposhtme janë përfshirë 5 (pesë) transaksionet më të rëndësishme, me vlerë mbi €2.0 milionë, të cilat janë nënshkruar gjatë gjithë vitit kalendarik 2024, pa marrë parasysh realizimin e tyre.

Kontratat e Nënshkruara gjatë vitit 2024	Vlera e Publikuar
Përvetësimi i tokave 100.70 ha	30,242,000
Furnizim me Kamion Transportues Dampër	2,955,200
Furnizim me Buldozer ( 3 copë)	1,468,142
Furnizim me rule për PKX	661,091
Asfaltimi i rrugës për kyçje në rrugën Dardhishtë deri në hyrje në Mirash	374,745
Furnizim me rotor të thermitoreve komplet	200,000
Ndërrim i stabilimenteve 6.3Kv (2BA -2BB),0.4Kv (2CA,2CB,2CC) si dhe zbarrave (2BA,2BB dhe 2 BT)	3,684,750
Sigurimi Fizik i Objekteve të KEK-ut	2,746,970
Furnizim me karburant të naftës diesel ,për kaldaja dhe motor diesel –LOT 1	11,547,539
Furnizim me transformator 400MVA,24 400kV për njësinë B-1	4,749,601

**Tabela 10. Transaksionet kryesore gjatë vitit 2024**

## SYGJERIME DHE PROPOZIME

Përkundër performancës së mirë viteve të fundit, KEK-u mund të ballafaqohet me vështirësi të natyrave të ndryshme, dhe me efekt në veprimtarinë e saj.

Siç është cekur më lartë korporata ka për detyrë ti analizoj të gjitha rreziqet e mundshme në planin afat-shkurtë, afat mesëm dhe afat gjatë. Identifikimi i rreziqeve potenciale është kruciale për produktivitetin e korporatës.

Investimet financiare në riparimet e blloqeve në TC A dhe TC B si dhe investimet në blerjen apo riparimin e teknologjisë punuese në Mihje janë të domosdoshme për një funksionalitet të mirë. Vlen të theksohet se planifikimi i buxhetit për vitin vijues duhet të bëhet në mënyrë pragmatike që shkurtesat në buxhet të mos rezultojnë fatale për operimin funksional të korporatës.

Gjithashtu duhet kushtuar rëndësi edhe më të madhe problemit serioz që janë remontet apo ndaljet e planifikuara të TC-ve, sipas planit operativ kur kërkesa për energji elektrike është e ulët.

Rritja e efikasitetit të organeve të gjyqësisë në realizimin e ankesave dhe padive të KEK-ut kundër keqpërdoruesve të natyrave të ndryshme, do të ndikonte në zgjidhjen e shumë kontesteve dhe dyshimeve gjë që do të ndikonte në mbar-vajtën më të mirë dhe më të sigurt të Korporatës.

Menaxhmenti i KEK-ut i mbetet besnik vizionit të korporatës që është prodhimi i energjisë elektrike i bazuara në kosto sa më të ulët dhe me ndikim minimal në ndotjen e ambientit.